



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Shëndetësisë - Ministarstvo zdravstva - Ministry of Health
Divizioni i Prokurimit/Divizia Nabavke/Procurement Division

Prishtine datë, 13.03.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit Ministrise se Shendetsise, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit per Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe Rregulloren për Prokurimin publik të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për ri-shqyrtim** të datës 08.03.2024 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Sinorg Pharmaceuticals** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” me nr. prokurimi **206-24-573-1-1-1**, nxjerr:

V E N D I M

- I. **HEDHET POSHTË**, si e jashtëafatshme ankesa e OE ankues **Sinorg Pharmaceuticals**, e datës 08.03.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit: “Furnizim me Barna nga Lista Esenciale” me nr. prokurimi **206-24-573-1-1-1**, pasi që e njëjta është parashtruar jashtë afatit ligjor për rishqyrtim në Autoritetin Kontraktues.
- II. Mbetet ne fuqi, Njoftimi për Kontratë i datës 31.01.2024 dhe sqarimet shtesë ne procedurë;
- III. Autoriteti Kontraktues, vazhdon me aktivitetin e prokurimit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A R S Y E T I M

Operatori Ekonomik **MEDI MAX SH.P.K** me datën 08.03.2024 ka parashtruar kërkesë për ri-shqyrtim e cila është e jashataftshme për tu trajtuar.

Afati i fundit për dorëzim te kërkesës për rishqyrtim ka qene deri me 07.03.2024 ora 16:00, ku brenda këtij afati është parashtruar një kërkesa për rishqyrtim nga OE Provit Pharmaceutical SH.P.K, e cila është shqyrtuar dhe është shtyre afati për ofertim deri me datën 15.03.2024 ora 14:00.

Baza Ligjore për refuzim të Kërkesës për Ri-shqyrtim

Nenin 60.1(a) i Rregullave te prokurimit publik

Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzim të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për

dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Kronologjia

Autoriteti Kontraktues, ka shpallur aktivitetin e prokurimit me date 31.01.2024.

Afati i fundit për dorëzim të tenderëve ishte 13.03.2024.

Me date 04.03.2024 është bere korrigjimi dhe shtyrja e afatit për ofertim për datën 15.03.2024.

Me date 27.02.2024 është parashtruar një kërkesë për rishqyrtim, e cilat është trajtuar me datën 04.03.2024 dhe është bere shtyrja e afatit për ofertim për datën 15.03.2024.

Ne perputhje me nenin 63.1.1 (b)., i cili nen përcakton "Kurdo që refuzimi i kërkesës ndërlidhet me njoftimet për kontratë, dokumentet e tenderit, Autoriteti kontraktues vazhdon më tutje me aktivitetin e prokurimit duke vlerësuar dhe konsideruar arsyet e refuzimit dhe rrethanat në të cilat ndodhet aktiviteti i prokurimit" Ministria e Shëndetësisë me date 04.03.2024, ka publikuar Njoftimin mbi Korrigjimin e procedurës dhe ka shtyre afatin e dorëzimit deri me date 15.03.2024.

Kërkesa për rishqyrtim nga ana e juaj është dorëzuar me date 08.03.2024.

Ne perputhje me nenin 60.1. (a) , kërkesa e juaj për rishqyrtim është dorëzuar jashtë afatit kohor sepse afati prej se paku 5 ditëve ***nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzim të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.***


Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si ne dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së. Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. OE Sinorg Pharmaceuticals.
3. Operatorëve ekonomik te interesuar.



Berat Marmullaku

Zyrtari përgjegjës i Prokurimit